





Nga integriteti akademik te VET: EÇUG dhe Task Forca SINCERE në MeetUp CB VET për Ballkanin Perendimor

Universiteti “Eqrem Çabej”, Gjirokastrë mori pjesë në sesionin informues **MeetUp**, të organizuar në kuadër të thirrjes **CB VET për Ballkanin Perëndimor**, ku u mbledhën mbi **85 përfaqësues të arsimit dhe formimit profesional (VET)** nga rajoni, si dhe zhvillues projektesh nga Bashkimi Evropian.

Sesioni shërbeu si një hapësirë informimi dhe shkëmbimi mbi mundësitë e financimit dhe zhvillimit të projekteve, duke ofruar orientime të vlefshme për përgatitjen e aplikimeve në kuadër të thirrjes aktuale për propozime.

Në këtë aktivitet morën pjesë gjithashtu **anëtarët e Task Forces për Integritetin Akademik**, e ngritur në kuadër të projektit **Erasmus+ SINCERE**, duke forcuar ndërveprimin ndërmjet nismave për cilësinë, integritetin akademik dhe zhvillimin e kompetencave profesionale në arsimin e lartë. (Foto)





Screen share

dragana.sofranac

Hayriye ULAŞ TARAF (TR)-Necm...

Jelena Nastic

Ksenija Milic

Notebook

Valbona Duri

vesna bratovic UNTZ BIH

